



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
KRYESIA

Prot 127  
Dt. 01.02/24

Vendim nr. 16 datë 01.2.2024

**Për ngritjen e komisionit të posaçëm për ndjekjen në zbatim të projekteve arkeologjike në zonat A dhe B**

Mbështetur në nenet 5 pika 34; 26 pika 2; 28 pika "ë"; 36 pika 1; 48 pika 2; 53 pika 3/iv; 133 pikat 6 dhe 8; 135; 158 pika 4/b dhe 275 pika 1 të Ligjit nr. 27/2018 *Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*;

Referuar vendimit nr. 730 datë 13.12.2023 të Këshillit të Ministrave *Për deklarimin "pasuri kombëtare e paluajtshme" të zonave A dhe B të qytetit të Sarandës "Kalasë së Lëkursit" dhe "Manastirit të 40 Shenjtorëve" dhe miratimin e zonimit e të planit për ruajtjen, mbrojtjen e administrimin e tyre*;

Në zbatim të detyrimeve që burojnë nga dokumenti bashkëlidhur aktit nënligjor sipërcituar *Plani për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e zonave arkeologjike*, neni 3 pika "ç";

Në përputhje me nenin 4 pikat 4, 9 e 14 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Në përgjigje të shkresës nr. 6424/1, 28.12.2023, të Ministrisë së Kulturës;

Pas këshillimit me drejtuesit e Institutit të Arkeologjisë e të komisionit të përhershëm të histori-arkeologjisë;

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 01.2.2024

Vendosi:

1. Pranë Institutit të Arkeologjisë ngrihet komisioni i posaçëm për ndjekjen në zbatim të projekteve shkencore arkeologjike në zonat A dhe B të qytetit të Sarandës dhe në të gjitha zonat arkeologjike të kategorisë A dhe B, sipas përkufizimit në Ligjin nr. 27/2018 *Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë*;

2. Në përbërje të këtij komisioni të jenë: akad. Adem Bunguri, dr. Elio Hobdari, prof. asoc. dr. Saimir Shpuza, dr. Sabina Veseli e dr. Melsi Labi;

3. Komisioni i posaçëm t'u përgjigjet detyrave që përcaktohen në Ligjin nr. 27/2018 *Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë për Akademinë e Shkencave, Institutin e Arkeologjisë dhe "institucionet e specializuara"*;

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

